



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:217292

Datë: 10.07.2020

Numri i dokumentit: 01019415

C.nr.444/18

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA NË KLINË - gjyqtari i çështjes Prenk Palushi, asistente administrative Violeta Lecaj- Lulaj në çështjen juridike civile kontestimore të paditësit: N. M. nga Klina të cilin e përfaqëson av. Fisnik Merlaku nga Klina Rr”Skender Rexhepi”pn, kundër të paditurës: K. e K.-D. e A, bazën juridike: Pagesa e orëve mësimore si dhe anulimi i vendimit Nr....-.../... i dt....., jashtë seancës gjyqësore me dt.10.07.2020, bijë këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

REFUZOHET NË TËRËSI – si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit N. M. nga Klina, ndaj të paditurës: K. e K.-D. e A, përmes të cilës paditësi ka kërkuar nga e paditura që ti kompensoj diferencën e të ardhurave mujore deri në shumën prej euro më kamatë prej 8% duke filluar qe nga data e deri në pagesën definitive sipas kontratës se lidhur me dt....., dhe orëve shtese sipas vendimit nr.../...-... i dt., të anulohet vendimi Nr...-.../.. i dt....., si dhe ti kompensohen shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit nen kercenim të përmbarimit të detyrueshëm, **për shkak se pala paditëse heq dore nga kërkesëpadia.**

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë, më dt. i autorizuari i paditësit N. M. nga Klina, av.Fisnik Merlaku Rr”Skender Rexhepi”pn, ka ushtruar padinë ndaj të paditurës: K. e K.-D. e A, baza juridike: Pagesa e orëve mësimore si dhe anulimi i vendimit Nr....-.../... i dt.....

Paditësi kësaj gjykate i dorëzoi parashtresën më dt....., përmes te cilës heqë dorë nga kërkesëpadia e dt..... e cila kërkesëpadi ka te bëjë me petitumin e kërkesëpadiisë te theksuar si ne diapozitiv te këtij aktgjykimi ,si dhe me pagesën e shpenzimeve procedurale të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit, nen kërcënimin e përmbarimit ligjor. Paditësi në parashtresën drejtuar kësaj gjykate si më lartë thekson se nuk ka interes juridik të ndjekë këtë qeshtje në gjykatë qe pala e paditur ka përmbushur kërkesëpadiinë në tërësi si në padi.

Gjykata konsideron se veprimet disponibile të palës paditëse të ndërmarra ne këtë qeshtje juridiko civile përmes të cilave përfundon në tërësi procesi gjyqësor, nuk janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara në nenin 3.3 të LPK-së, në të cilat dispozita përcaktohet ”palët mudë të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko civile që i kanë parashtruar gjatë

procedurës. Palët mund të heqin dore nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë ujdi gjyqësore lidhur me kontestin e tyre. Gjykata nuk do ti miratojë disponimet e palëve që janë në kundërshtim me a) rendin juridik ,b)dispozitat ligjore ,c)rregullat e moralit publik”.

Andaj gjykata nga arsyet e theksuara më lartë konform dispozitave ligjore të nenit 149.1 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË KLINË
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C. nr.444/18, me dt. 10.07.2020

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar
Ankesa drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë,
ne afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se të njëjtit,
përmes kësaj gjykate.

G j y q t a r i:
Prenk Palushi

Numri i lëndës: 2019:217292
Datë: 10.07.2020
Numri i dokumentit: 01019415